



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 875/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Flora Sadiku – Arifi nga Klllokoti, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e pa afatshme ankesa e Flora Sadiku – Arifit nga Klllokoti.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë Anr.875/13, me datë 15.11.2013 nga Flora Sadiku – Arifi nga Klllokoti, në të cilën pretendohet se në vendvotimin nr.3704D/01D, pas numërimit të votave pasi që kishte shkelje dhe prishje të fletëvotimeve për Kuvendin Komunal në Klllokot, nga kjo shkelje e tillë më ka dëmtuar mua si kandidatë për Kuvend Komunal dhe subjektin politik LDK-në.

Parashtresuesi i ankesës ka propozuar që të rinumërohet vendvotimi me nr.3704D/01D, në Mugillë dhe të bëhet verifikimi i fletëvotimeve për Kuvendin Komunal.

PZAP-i, shqyrtoi afatshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e pa afatshme**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pa afatshme ngase ankesa në fjalë nuk është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjorë që është 24 orë nga mbyllja e Qendrave të Votimit QV, ky afat ligjorë ishte deri 04.11.2013 në 19:00, siç përcaktohet me nenin 119.1 të LZP-së, se për të gjitha parregullësit lidhur me ditën e votimit mund të parashtrohet ankesë në PZAP brenda afatit të sipërsënuar. Andaj ankesa nga pala e interesuar është parashtruar në PZAP me datë 15.11.2013, nga kjo del se ankesa në fjalë është e pa afatshme.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesën e bazuar në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre

*rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP-i refuzon ankesat te cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

A nr. 875/2013 më datën 15.11.2013



**Këshillë juridike:** *Ndaj këtij vendimi siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*